

... rrethim zgjidhjen...



... është Qeveria e Nxënësve!



Save the Children

E gjetëm zgjidhjen ...është Qeveria e Nxënësve!
Udhërrëfyes mbi Qeverinë e Nxënësve.-Tiranë:
Save the children, 2003.
108 f.: me il.:21 cm
ISBN.:99927-786-6-0

Botim i:

Save the children – Program për Shqipërinë
Përgatitur në kuadrin e projektit të Grupshkollave

Ky libër nuk mund të shitet ose të përdoret për qëllime përfitimimi

Hartuar nga Grupi i Punës:

Blerina Kashari, Save the Children

Brikena Zogaj, Save the Children

Refik Çela, Drejtoria Arsimore, Dibër

Shaziman Manja, Drejtoria Arsimore, Dibër

Grupi i punës u udhëhoq nga:

Blerina Kashari, Save the Children



E gjetëm zgjidhjen...,

... është Qeveria e Nxënësve!



Udhërrëfyes për
Qeverinë e Nxënësve



Falenderime



Në këtë hapësirë të vogël
duam të falenderojmë
ata që bënë një punë
mjaft të madhe. Janë anëtarët e
Qeverisë së Nxënësve në shkollat
tetëvjeçare "Selim Alliu",
"Demir Gashi" dhe Maqellarë,
në qytetin e Peshkopisë të cilët ishin
pjesëmarrës në shkrimin e këtij libri.
Ju do të keni mundësi të njiheni
me ta gjatë leximit,
pasi ata do të jenë të pranishëm
me aktivitetet e tyre, intervista dhe
shembuj konkrete të funksionimit
të një Qeverie Nxënësish.



Përmbajtja

Falenderimefq. 4

Kapitulli I Prezantim me Qeverinë e Nxënësvefq. 7

Kapitulli II Zgjedhja e Qeverisë së Nxënësvefq. 17

Kapitulli III Përfitimet nga Qeveria e Nxënësvefq. 27

Kapitulli IV Kush do të doje të ishe?fq. 37

Kapitulli V Edhe ne bëjmë takimefq. 55

Kapitulli VI Muri i Mundësive dhe Lule mos më prek.....fq. 69

Kapitulli VII Të përfshijmë të tjerët.....fq. 75

Kapitulli VIII Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës.....fq. 91

Fjalorifq. 100

Fotofq. 106

Viola Halili



Evisa Kallaverja

Malvina Torba

Eranda Vishka

Erind Saraçi

Hegla Luca

Ditjon Hoxha



Elsa Toçi

Rami Jakupi

Haxhi Sheshi

Valdrin Vlesha


Besmir Gjoni

Brunild Xhili

Armand Xhafa



Kapitulli



Prezantim me
Qeverinë e Nxënësve

Mirë se vini në këtë libër udhërrëfyes për Qeverinë e Nxënësve!

Të gjithë ju ndoshta po mendoni se për çfarë ju duhet një udhërrëfyes i tillë? Arsyeja është e thjeshtë. Të gjithë fëmijët në Shqipëri e meritojnë të kenë një libër për Qeverinë e tyre.

Të gjithë ju që e keni krijuar Qeverinë tuaj nëpër shkolla, por edhe për ju që nuk e njihni atë, në këtë libër do të gjeni shumë situata apo modele që mund t'ju nxisin të mendoni e të ideoni aktivitete të ndryshme për ta bërë më të dashur qëndrimin tuaj në shkollë.



Hej, përshëndetje të gjithëve.
Unë jam Zanë **Kokëkashita**, me **Kësulë të Kuqe**.
Herë pas here do të gjndem pranë jush për sugjerime
të ndryshme për ta bërë më të këndshëm
udhëtimin tonë nëpër faqet e këtij libri
Më ndiqni se do të **KËNAQEMI!**



Çfarë është
Qeveria e Nxënësve
dhe përse na duhet ajo?

Nga kush përbëhet
Qeveria e Nxënësve?

Çfarë
funksionesh ka?

Nga kush ndihmohet
Qeveria e Nxënësve?



A varet nga drejtoria e shkollës?

Sa Qeveri Nxënësish ka gjithsej në Shqipëri?

A ka lidhje me Qeverinë e vërtetë dhe a ndihmohet prej saj?

A ka ndarje partiake në Qeverinë e Nxënësve?

Çfarë bën Qeveria e Nxënësve?

Ky libër shpreson t'u japë përgjigje disa prej këtyre pyetjeve, apo dhe të tjerave të cilat ju tashmë po i mendoni.





E pra, ç'është kjo fjalë kaq e madhe "Qeveri Nxënësish?" Kush e shpiku atë e përse ia kemi nevojën?

Qeveria e Nxënësve mund të jetë një fjalë e madhe, por ajo është për fëmijët, për nxënësit.

Në Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është një listë e të drejtave themelore që kanë të gjithë fëmijët, në një prej neneve

(neni 12) thuhet:

"Fëmija ka të drejtë të thotë lirisht mendimin e tij në çështjet që lidhen me të".

Nëpërmjet pjesëmarrjes në Qeverinë e Nxënësve, ju përmbushni këtë të drejtë e cila thotë se ju jeni në gjendje të shprehni atë që mendoni.



Ja disa gjëra që na vijnë
ndër mend kur themi
“Qeveria e Nxënësve”



Grup i përzgjedhur nxënësish.



Qeveritarë të ardhshëm.



Qeverisje nxënësish.




Gonxhe që do të çelin
në të ardhmen.



Qeveria e Nxënësve është një mundësi shumë e mirë për t'u marrë me çështjet e fëmijëve në shkollë. Ka mënyra të ndryshme se si mund të ndërtohet një qeveri e tillë, por në përgjithësi çdo klasë zgjedh përfaqësuesin e saj për të qenë anëtar i Qeverisë së Nxënësve. Përfaqësuesit duhet të propozohen dhe të votohen nga nxënësit e klasës. Pasi të jenë zgjedhur është shumë e rëndësishme që ata të shprehin jo vetëm mendimet e tyre, por edhe mendimet e të gjithë nxënësve që ata përfaqësojnë.

Informacion i nevojshëm

Diagrama tregon se sistemi arsimor është një hierarki. Ata që janë në majë të saj kanë më shumë pushtet, ata që janë më poshtë, kanë më pak.



“Demokrati do të thotë, përveç të tjerash, që njerëzit të cilët kanë më shumë pushtet, kërkojnë opinionin dhe mendimin e njerëzve të tjerë, të qeverisur prej tyre.”

“Mendoni pak: Pse është e rëndësishme për mësuesit të kërkojnë mendimin e nxënësve? Nxënësit formojnë grupin më të madh të një shkolle.”



Kapitulli



Zgjedhja e

Qeverisë së Nxënësve



Çfarë nënkupton zgjedhja në Qeverinë e Nxënësve?

- ① Nxënësit të japin preferencat e tyre në lidhje me përfaqësimin në Qeverinë e Nxënësve.
- ② Përgjegjësia ndaj klasës dhe shkollës.
- ③ Të fitosh votëbesimin e klasës.
- ④ Të kesh vlerësimin e klasës.
- ⑤ Të mbështetesh nga nxënësit.
- ⑥ Të përfaqësosh klasën.



Burime të vlefshme ku mund të marrim informacion?



- ✦ Mësuesit koordinatorë të Qeverisë së Nxënësve.
- ✦ Senatorë të mëparshëm.
- ✦ Drejtorja e shkollës.
- ✦ Libri i Qeverisë së Nxënësve.
- ✦ Nxënësit e klasës.



✓ Kush mund të kandidojë?

Çdo nxënës është i lirë të kandidojë, nëse e ndjen veten të aftë të ndihmojë dhe të japë kontributin e tij për përfaqësimin e problemeve të klasës dhe të shkollës.

Ai duhet të propozohet nga shokët, e për këtë duhet të tregohet i shkathët, të mbajë fjalime, të aktivizohet në aktivitete të ndryshme, të krijojë sa më shumë shoqëri me klasën, të jetë vullnetar në zgjidhjen e problemeve të klasës e të fitojë autoritet.



Ç'duhet të bësh që të zgjidhesh anëtar i Qeverisë së Nxënësve?

- Të fitosh autoritet.
- Të tregohesh i shkathët.
- Të ndjesh përgjegjësi ndaj klasës.
- Të tregohesh i aftë në zgjidhjen e disa problemeve të klasës para zgjedhjeve.

Të fitosh respektin e klasës.

- Të jesh i dashur miqësor me klasën për të fituar besim te shokët.
- Të jesh aktiv për problemet e klasës.
- Të tregosh aftësitë që ke.
- Të bësh dhe të mbash premtimet.
- Të tregohesh inteligjent.
- Të nxisësh një atmosferë paqeje dhe mirëkuptimi në shkollë.
- Të shuash konfliktet ndërmjet nxënësve, apo edhe midis mësuesve e nxënësve.

Procedura e zgjedhjeve

Hapi I

Nxënësit e çdo klase propozojnë emrat e atyre shokëve apo shoqeve të klasës që janë të aftë t'i përfaqësojnë në Qeverinë e Nxënësve. Ata janë të lirë të propozojnë këdo që mendojnë se ka ide, është i shkathët dhe mund të ndihmojë për zgjidhjen e problemeve të klasës, apo dhe në përfaqësimin e mendimit të klasës në Qeverinë e Nxënësve.

Hapi II

Nxënësit e propozuar përgatitin një fjalim të shkurtër të cilin e mbajnë përpara klasës. Në këtë fjalim ata duhet të tregojnë idetë e tyre dhe arsyet se përse shokët e klasës duhet ta votojnë e ta zgjedhin senator.





Hapi III

Zhvillohet votimi, ku të gjithë nxënësit e shprehin mendimin e tyre me anë të VOTËS, për kandidatin që u pëlqen më shumë. Votimi zhvillohet i fshehtë.



Hapi IV

Secila klasë zgjedh përfaqësuesin e saj për të qenë anëtar i Qeverisë së Nxënësve.



Hapi V

Qeveria e Nxënësve e sapo zgjedhur takohet dhe fillon punën.

~~Një rast zgjedhësh që nuk duhet të ndodhë:~~

 Kur zgjidhet një nxënës i mirë në të gjitha lëndët, por nuk është i aftë në drejtimin e klasës. Atë e zgjedhin vetëm për emër.

 Kur i merr shokët me të mirë e pastaj i lë pas dore.

 Kur e merr votën me dhunë.

~~Një rast zgjedhjesh që nuk duhet të ndodhë:~~



Kur një nxënës kërkon të zgjidhet vetëm për t'u dukur e jo për punë.




Kur nuk zhvillohen fare zgjedhje, por vendos mësuesi kujdestar.



Kur nxënësit vendosin vetë pa pyetur të tjerët.



Kur procesi i zgjedhjeve nuk bëhet seriozisht, por sa për të thënë.



Kapitulli



**Përfitimet nga
Qeveria e Nxënësve**

Çfarë ofron Qeveria e Nxënësve?



★ Shkëmbejmë dhe fitojmë përvojë.

★ Mbledhemi me të tjerët.

★ Koordinojmë marrëdhëniet me të tjerët.

★ Mbledhemi me organizimin e diskutimit.

★ Jemi në dijeni të problemeve të shkollës.

★ Mbledhemi të shprehemi më lirshëm.

★ Njohim dhe bashkëpunojmë me Qeveritë e Nxënësve në shkolla të tjera.

★ Mbledhemi të punojmë me grup.

★ Bëhemi të famshëm duke ndihmuar të tjerët.



Kush përfiton nga Qeveria e Nxënësve?

Të gjithë nxënësit, pavarësisht nga notat apo klasa, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të ndryshme.

Skollja, klasa, pasi nxënësit këshillohen të mirëmbajnë mjetet dhe mjediset e tyre.

Vetë Qeveria e Nxënësve (duke organizuar trainime).

Mësuesit, të cilëve nëpërmjet "kutisë së mendimeve" mund t'u sugjerohet të ndryshojnë diçka në vetvete.

Prindërit, në rastin kur fëmijët e tyre mësojnë së bashku me nxënësit e tjerë.

Mjedisi përreth duke lyer e mbjellë pemë dhe duke u kujdesur për pastërtinë e tij.



Çdo të thotë të marrësh pjesë në Qeverinë e Nxënësve?



Të kesh përgjegjësi të mëdha në përfaqësimin e klasës për probleme të ndryshme.



Të ngresh zërin për shqetësime.



Të jesh me pranë problemeve dhe të ndihesh krenar kur i zgjidh ato.



Të krijosh lidhje të ngushta shoqërore.



Të fitosh një përvojë të re.



Të njohësh më mirë vetveten.



Ju bën të ditur të tjerëve egzistencën e një dritareje për të shprehur mendimet.

Kush e ndihmon Qeverinë e Nxënësve?

-  **Drejtoria**
(merr vendime).
-  **Organizatat Jo Fitimprurëse**
(fonde, materiale, ide, trainime).
-  **Biznesmenët e qytetit**
(fonde, materiale, shërbime).
-  **Prindërit**
(nëpërmjet cilësive personale,
profesionit, mirëkuptimit,
informacionit).
-  **Drejtoria Arsimore**
(inspektorët, mjete mësimore).
-  **Bashkia ose Komuna**
(fonde, materiale, aktivitete,
Qendra Kulturore
e Fëmijëve, mjete).
-  **Nxënësit e shkollës**
(informacion, ide,
mendime, vullnetarë).
-  **Qeveritë e tjera me me shumë përvojë**
(ide, sugjerime, sqarime
shkëmbim përvoje).



Nxënësit dhe mësuesit punojnë së bashku.

Bëjini të ditur nxënësve të klasës suaj
se çfarë gjërash diskutohen në
Qeverinë e Nxënësve.


Përmes kësaj qeverie, nxënësit bëhen partnerë
me njëri-tjetrin, por ata bëhen partnerë
me mësuesit gjithashtu.

Qeveria e Nxënësve, mund të ftojë në
takimet e saj mësuesit dhe të diskutojnë
çështje që u interesojnë apo i shqetësojnë
fëmijët. Mësuesi koordinator mund
të ndihmojë në lidhjen e nxënësve
me mësuesit e tjerë.

Mos harroni! Ju duhet të bëni punë të mira, që t'ju besojnë nxënësit dhe mësuesit!

Ju duhet të jeni te besueshëm që ata të pranojnë të bëhen partnerë me ju





"Përmes Qeverisë së Nxënësve, nxënësit dhe mësuesit mund ta bëjnë shkollën një vend më të mirë se ç'është sot..."

"Përmes Qeverisë së Nxënësve, të gjithë nxënësit në shkollë kanë mundësinë të shprehin se çfarë duan dhe të kuptojnë se mendimi i tyre merret në konsideratë."

Kujtesë: Shfrytëzoni këto partneritete për më të mirën e të GJITHË fëmijëve të shkollës.

**Arsye për të qenë
të lumtur kur marrim pjesë
në Qeverinë e Nxënësve:**



Kur puna e nisur përfundon me sukses.



**Marrëdhëniet e mira mes senatorëve, aktivitetet
e shumta dhe ndihmesa që u jepet nxënësve të tjerë.**



Organizimi i aktiviteteve sportive.



**Kur problemet zgjidhen në mënyrë
që të mbeten të kënaqur të dy palët.**



**Nga organizimi i aktiviteteve të ndryshme dhe
plotësimi i dëshirave të nxënësve në këto aktivitete.**



Arsye për të qenë të lumtur kur marrim pjesë në Qeverinë e Nxënësve:



Sepse je në pozitë më të lartë dhe
më i njohur nga të tjerët.



Sepse pas ditëve me shi ka gjithmonë ditë me diell;
pas problemeve do të gjendet një rrugë.



Sepse zhvillon aktivitete të cilat
janë përvojë e re për nxënësit.




Të gjithëve u dëgjohet mendimi njësoj.



Realizimi i qëllimeve të përbashkëta.





Kapitulli

A purple hand silhouette is centered on a light purple background. The hand is open, with fingers spread. A thought bubble, consisting of three small circles of increasing size, leads from the wrist area of the hand to a large, pink, cloud-like shape at the bottom of the page. Inside this pink cloud, the text 'Kush do të doje të ishte?' is written in orange.

Kush do të doje
të ishte?

SENATORI

- 🔥 Ndihton në problemet e klasës.
- 🔥 Përfaqëson mendimet e klasës.
- 🔥 Përcjell mendimet e Qeverisë së Nxënësve në klasë.
- 🔥 Organizon aktivitete në bazë klase.
- 🔥 Bën propozime për aktivitete në klasë.



Të jetë i durueshëm.

Cilësitë



Të jetë i shkathët.



Të jetë i aftë për të zgjidhur probleme për klasën.



Të jetë gjakftohtë, i qetë.



Të mbajë situatën nën kontroll.



Të mos premtojë kot.



Të jetë komunikues.



Të jetë konkret.



Të jetë i përkushtuar.



Të jetë i qartë në mendime.



Të jetë këmbëngulës.

Senatori nuk duhet:

- ◆ Të jetë i dhunshëm.
- ◆ Të fyejë, e të flasë me ton të ashpër.
- ◆ Të mendojë vetëm për vete.
- ◆ Të bëjë dallime mes shokëve.
- ◆ Të shprehë vetëm mendimin e tij.
- ◆ Të dalë kundër interesave të atyre që e kanë zgjedhur.

SEKRETARI

1. Mban procesverbalin (shënime)

2. Mban lidhje të ngushta me funksionarët e tjerë.

3.

4.

5.



Kujtesë: Çdo gjë duhet dokumentuar për të qenë të hapur dhe për t'u treguar të tjerëve çfarë është bërë (fotografi, shënime, etj).



FINANCIERI

Mban buxhetin dhe e shfrytëzon atë në të mirë të të gjithëve.

Bën planin e shpenzimeve të aktiviteteve dhe blerjeve.

Mban përgjegjësi për shpërdorimin e parave dhe bën bilancin.

Gjen mënyra për të gjetur fonde në bashkëpunim me senatorët e tjerë.

Raporton te Qeveria e Nxënësve me dokumentat përkatëse (ruan faturat e shpenzimeve).

Rëndësia e financierit:

- # Manaxhon paratë.
- # Përdor paratë për të mirën e të gjithë fëmijëve.

KRYETARI

Detyrat

- Bashkëpunon me presidentin.
- Drejton mbledhjet.
- Lajmëron senatorët për mbledhje jashtë rradhës.

Rëndësia

- Siguron qetësinë dhe mbarëvajtjen e mbledhjes.
- Lehtëson punën e Presidentit.
- Zëvendëson Presidentin kur ai mungon.

Vështirësitë

- Drejton mbledhjet në këmbë
- Barazpeshon mendimet / vendimet e ndryshme.

KOORDINATORI I QEVERISË SË NXËNËSVE

- Koordinon punën e Qeverisë së Nxënësve.
- Bashkëpunon me Qeverinë e Nxënësve.
- Ndiemon Qeverinë e Nxënësve në hapat e para.
- Bën ndërlidhjen midis Qeverisë së Nxënësve dhe drejtorisë.
- Nuk merr vendime në emër të Qeverisë së Nxënësve.
- Merr pjesë në mbledhjet e Qeverisë së Nxënësve kur ftohet nga ajo.
- Është i pranishëm në aktivitete.

Cilësitë

- Të jetë i komunikueshëm me nxënësit.
- Të jetë pranë fëmijëve në mendime dhe të folur.
- Të jetë i aftë për rolin që ka.
- Të jetë gjakftohtë e i durueshëm.

PRESIDENTI



- Drejton Qeverinë e Nxënësve.
- Kontrollon çdo gjë që bën Qeveria e Nxënësve.
- Përfaqëson shkollën në takime të ndryshme jashtë dhe brenda saj.
- Propozon dhe jep miratimin përfundimtar të aktiviteteve.
- Ndërhyt kur senatori nuk ka mundësi të zgjidhë një çështje të caktuar.
- Merr pjesë si vëzhgues në mbledhjet e bordit të shkollës dhe këshillit pedagogjik.
- Raporton te mësuesi koordinator.

Vështirësitë

- # Përballet me prindërit / nxënësit.
- # Rrezikon të mungojë në mësimet nëse ka shumë punë.

Intervista me anëtarët e Qeverisë së Nxënësve

Si e ndieni veten?

Ndihem i gëzuar dhe krenar që jam anëtar i Qeverisë së Nxënësve.

Cili ka qenë momenti më i lumtur?

Kur jam zgjedhur president.

Po i hidhuni?

Kur një aktivitet që menduam ne dështoi.

A ndihesh i fyer kur nuk zgjidhni problemet në senat?

Po, sepse tregon paaftësinë time në lidhje me problemin.

A ndikon pjesëmarrja në Qeveri për të ardhmen tuaj?

Po, sepse kam mësuar shumë nga kjo përvojë.

Cilat janë përfitimet tuaja qëkurse jeni zgjedhur Presidenti i Qeverisë së Nxënësve?

Jam miqësuar me shumë nxënës, kam njohur vetveten.





Si u zgjedhe senatore?

Me vota, pra kam hedhur kandidaturën.

Çfarë ndieve në ato momente?

Nder, kënaqësi dhe përgjegjësi.

Pasi more pjesë në takimin e I të

Qeverisë së Nxënësve, çfarë të la më shumë përshtypje?

Mënyra e organizimit.

Cilat janë aktivitetet konkrete dhe ato në letër për të ardhmen?

Në letër janë – Lulja më e bukur, furore, mbrëmje, piknik.

Konkrete-biblioteka nxënësi të nxënësi, mbledhja e rrobave për nxënësit në vështirësi, etj.

Çdo të thotë të jesh anëtar i

Qeverisë së Nxënësve?

Të kesh shumë përgjegjësi.

- 
- 😊 *Kur u zgjodhët anëtar i Qeverisë së Nxënësve? Në klasë të pestë.*
 - 😊 *Cila është detyra juaj? Senatore.*
 - 😊 *Sa anëtarë ka Qeveria e Nxënësve në shkollën tuaj? Çdo klasë përfaqësohet me një senator, kurse klasat e teta me dy.*
 - 😊 *Çfarë ndietë kur u zgjodhët në Qeverinë e Nxënësve? Kënaqësi dhe përgjegjësi.*
 - 😊 *A keni autoritet në shkollën tuaj? Shpresoj se po.*
 - 😊 *Si ka reaguuar Drejtorja apo Koordinatori i Qeverisë së Nxënësve? Na kanë ndihmuar me sa mundësi që kanë pasur.*



Si u zgjodhët në Qeverinë e Nxënësve?
Nga klasa.



Çfarë funksioni keni?
Financiere.



Si u ndietë kur u zgjodhët senator?
Me shumë emocione e kënaqësi.



A jua mbështesin mendimet?
Varet nga rasti.



Kur ndiheni të kënaqur në punën tuaj?
Kur puna ka sukses.



A është kënaqësi të marrësh pjesë
në Qeverinë e Nxënësve?
**Shumë kënaqësi, sepse zbuloj
vlerat e mia.**





Kur keni marrë pjesë në Qeverinë e Nxënësve?
Në vitin 2002, kur ajo u krijua në shkollën tonë.



Si e ndieni veten në Qeverinë e Nxënësve?
Shumë mirë kur problemeve që shtrohen u jap zgjidhje, dhe keq kur nuk jap zgjidhje.



Si u zgjodhët?
U zgjodha senator i klasës nëpërmjet votimit të lirë të shokëve dhe shoqeve të klasës.



Si keni ndihmuar ju në mbarëvajtjen e punëve mësimore të klasës?
Kemi ndihmuar nxënësit e dobët në mësimet nëpërmjet nxënësve të mirë.



A keni mundur të zgjidhni ndonjë problem që ka dalë në klasë ose brenda shkollës?
Po, problemin e ngrohjes së klasës duke i zëvendësuar xhamat e thyer me të rinj.



Çfarë ju pëlqen të bëni në shkollë?
Ne na pëlqen të bëjmë më shumë aktivitete ku të marrin pjesë të gjithë nxënësit.



A jeni ndier ndonjëherë të dëshpëruar për diçka që s'e keni arritur brenda Qeverisë së Nxënësve?
Kur nuk kam mundur t'i jap zgjidhje ndonjë problemi që më është paraqitur, jam ndier keq pasi nuk arrita të realizoj një përgjegjësi që më është ngarkuar.





Çfarë roli keni në Qeverinë e Nxënësve?

Unë jam kryetar senati.



Si jeni ndierë kur u zgjodhët senator?

Jam ndier krenar dhe i kënaqur.



Çfarë aktivitetesth keni bërë?

Biblioteka nxënësi te nxënësi,
mbledhja e rrobave për fëmijët
në nevojë, piknik, etj.



A ka ndikuar kjo në formimin tuaj?

Sigurisht.



Ç'plane keni për të ardhmen?

Do të organizojmë
më shumë aktivitete.



Si mundët ju të vinit në Qeverinë e Nxënësve?



Nëpërmjet votave të fituara nga shumica e nxënësve.



Si u ndietë kur u zgjodhët senatore?



Shumë e emocionuar, e kënaqur dhe krenare.



A jeni krenare që merrni pjesë në një qeveri?



Po jam shumë krenare, sepse zgjidh shumë probleme.





😊 *A e ndieni se keni përgjegjësi ndaj shkollës?*

Po, përgjegjësia për shkollën është shumë e madhe.

😊 *A keni zhvilluar ndonjë aktivitet deri tani?*

Po, aktiviteti me nxënësit e dalluar, me pjesëmarrësit në konkursin e gjuhës, etj.

😊 *Çfarë roli keni në Qeverinë e Nxënësve?*

Unë jam kryetare Senati.





Si u ndietë kur u zgjodhët senator klase?

***I emocionuar dhe krenar,
sepse përfaqësoj klasën time
dhe u vij në ndihmë nxënësve
për çdo problem shqetësues.
Gjithashtu e kuptova që nxënësit
e klasës kishin respekt dhe
besim tek unë.***

***Të jesh anëtar i Qeverisë së Nxënësve
do të thotë të kesh autoritet ndaj klasës,
por gjithashtu shumë
detyra e sfida për të kryer;
ke detyrime ndaj
nxënësve në përgjithësi.***



Kapitulli



Edhe ne bëjmë takime

Programi



Programi është një listë e të gjitha gjërave për të cilat do të flitet gjatë një takimi i cili përgatitet nga drejtuesi i saj dhe sekretari.

Programi i një Qeverie Nxënësish

1. Ndjesë për mospjesëmarrje
2. Shënimet e mbledhjes së fundit.
3. Çështje për t'u diskutuar në këtë takim.
4. Ndonjë çështje tjetër.
5. Data dhe ora e mbledhjes tjetër.

1. Ndjesë për mospjesëmarrje.

Personat që nuk mund të vijnë në mbledhje dërgojnë një mesazh ku shpjegojnë arsyet e mungesës së tyre. Sekretari duhet të mbajë shënime emrat e tyre në rubrikën e caktuar.

2. Shënimet e mbledhjes së fundit.

Drejtuesi i mbledhjes sigurohet që të gjithë i kanë lexuar shënimet e mbledhjes së kaluar, ose i lexon me zë të lartë dhe i pyet nëse ato janë të sakta. Nëse po, ai i firmos ato. Nëse diçka është shprehur gabim, ose është lënë pa shkruar, ato korrigjohen e më pas drejtuesi i firmos.

3. Çështje për t'u diskutuar në këtë takim.


Kjo është pjesa më e rëndësishme e një mbledhje. ë mbledhurit diskutojnë çdo çështje të listës e cila është përgatitur nga sekretari dhe drejtuesi. Në të përfshihen sugjerime të reja të dërguara nga këshillat e klasave si dhe raporte nga komitete të tjera e anëtarë të qeverisë në lidhje me punët që ata kanë premtuar të bëjnë.

4. Ndonjë çështje tjetër.

Është një mundësi për të diskutuar shkurt diçka që mund të jetë harruar të përfshihet në program.

5. Data dhe ora e mbledhjes tjetër.

Secili duhet të dijë se kur do të zhvillohet mbledhja tjetër dhe kjo duhet të shkruhet në shënime.



SHËNIMET

Janë regjistrime të gjërave më të rëndësishme që thuhën në mbledhje si dhe të vendimeve që merren.



SI MBAHEN?

Gjatë mbledhjes, sekretari mban shënime për të gjitha vendimet që merren si dhe për çështjet e rëndësishme që diskutohen.



PËR KË JANË?

Për çdokënd në shkollë.
Shënime mund të fotokopjohen dhe t'u jepen të gjithë anëtarëve të qeverisë.
Mund t'u vijë në ndihmë përfaqësuesve të klasës kur duan të raportojnë përpara këshillit të klasës.



KU MBAHEN?

Sekretari i mban të gjitha shënime në një dosje apo bllok që quhet "Libri i shënimeve".

Përse na duhen shënimet?



Drejtuesit të mbledhjes i duhen për të planifikuar mbledhjen pasardhëse.



Anëtarët e qeverisë duhet t'i kontrollojnë për të parë nëse kanë premtuar të bëjnë diçka në mënyrë që ta mbarojnë përpara mbledhjes së ardhshme.



Çdokush duhet të ketë mundësinë të shikojë vendimet që janë marrë në të kaluarën.



Drejtuesit e shkollës mund të kenë nevojë të shohin shënimet në mënyrë që të mbahen të informuar mbi veprimtaritë e Qeverisë.



Mësuesi koordinator mund të ketë nevojë të shikojë shënimet për të diskutuar çështjet e Qeverisë së Nxënësve me mësuesit e tjerë të shkollës.

**KËSHITU PRA MBANI MEND:
SHËNIMET JANË MJAFT TË RËNDËSISHME.**



TË DREJTOSH NJË DISKUTIM



Çdo çështje program diskutohet më vete.



Diskutimin e udhëheq drejtuesi i takimit.



Nëse ju jeni drejtuesi i takimit, ndërkohë që zhvillohen diskutimet, pyesni veten:

- A e patën mundësinë të jepnin mendimin e tyre të gjithë ata që donin të flisnin?
- A inkurajohen më të urtët në klasë që të flasin edhe ata?
- A po flet më shumë se një person në të njëjtën kohë?



Pas diskutimit, klasa duhet të marrë një vendim.



Nëse ju jeni drejtuesi i takimit, pyesni klasën:

- A duhet të japim më shumë argumenta dhe arsyetime përpara se të marrim një vendim?
- Nëse do të marrim një vendim, a mundet dikush të bëjë një propozim (të japë një sugjerim) dhe dikush tjetër ta mbështesë atë (të thotë që bie dakort)



Votoni mbi propozimin.



Pas vendimit inkurajo anëtarët e Qeverisë së Nxënësve të ndajnë punën dhe t'u tregojnë nxënësve të klasës për vendimet e marra.



Një plan diskutimi

Tregoni qartë se për cilat pika të programit do të flasë secili.

- ? Pyesni në klasë së çfarë mendojnë nxënësit për çështjet e programit dhe kërkonte mendimin e gjithësecilit. Kjo është pjesa kryesore e diskutimit.
- ? Pyesni nëse dikush do të bëjë një propozim.
- ? Nëse dikush bën një propozim, pyesni nëse dikush tjetër do ta mbështesë atë.
- ? Kryeni votimin ku shprehen ata që janë dakort me propozimin dhe ata që janë kundër tij.
- ? Sigurohuni që sekretari të ketë mbajtur shënim vendimin e marrë.



TRYEZA E MBRETIT ARTUR



Mbreti Artur i Kamelotit është i famshëm për mënyrën se si i merrte vendimet. Ai këshillohej me një grup prej 12 vetësh që ishin kalorësit e tij më të besuar. Në këtë mënyrë ai merrte vendime edhe më të drejta pasi u jepte mundësinë të tjerëve të shprehnin mendimet e tyre për të mirën e të gjithëve. Tryeza e Mbretit Artur është një formë demokracie, ku secili ka një votë dhe vendimarrja realizohet me pjesëmarrjen e të gjithë të zgjedhurve.



Ky është një vend i sigurtë ku gjithëkush mund të flasë pa droje. Këtu mund të flitet për ndjenjat tuaja dhe për gjëra që janë të rëndësishme për ju. Të gjithë mund të shohin njëri-tjetrin pasi janë ulur në formë rrethi. Askujt nuk i lejohet të thotë apo të bëjë diçka që përjashton një tjetër. Flasin të gjithë me rradhë dhe dëgjojnë pa ndërprerë atë që flet.



Le të ndërmjetësojmë



Përpara se të filloni, sigurohuni se që të dy personat duan ta provojnë ndërmjetësimin për të zgjidhur problemin e tyre. Më poshtë jepet një mënyrë se si mund të veproni:



Kërkojini njërit prej tyre të shpjegojë problemin sipas mendjes së tij. Përsëritni pikat kyçe.



Bëni të njëjtën gjë me personin tjetër.



Pyesni personin e parë se si ndihet nga situata e krijuar.



Pyesni personin tjetër për të njëjtën gjë.



Përsëritini të dy personave ato që keni dëgjuar prej tyre.



Mos u përpiqni ta zgjidhni problemin për ta.



Pyetini me rradhë se si mendojnë ata se mund të zgjidhet problemi dhe se si mund të bien dakort për të ndryshuar sjelljen e tyre në të ardhmen.



Shkruani çdo gjë mbi të cilën ata bien dakort.



Tregojini nxënësve të tjerë të klasës suaj se problemi është zgjidhur. Nëse problemi nuk zgjidhet, mund të kërkonte nga klasa që të ndihmojë në tryezën e rrumbullakët.

Unë mendoj...kur ti...Sepse

Kur jeni i nevrikosur me dikë,
shpreheni në mënyrë të ashpër dhe me inat?

Nëse po, atëherë edhe ata do të jenë
të mërzitur e do t'ju kthehen po ashpër.

Por, nëse ju u thoni atyre:



"Unë mendoj...
kur ti...Sepse"

do t'ju ndihmojë të zgjidhni problemin në një mënyrë miqësore.

Kështu kur jeni të nevrikosur me dikë:

Mos ekuzoni (komunikim negativ)

Tregoni se si ndjeheni (komunikim pozitiv)



Komunikimi Negativ:



- A: Ta marrë dreqi! Ti nuk ke për të ma pasuar topin gjatë orës së lojës.
B: Pse të duket vetja e mirë me top ty?
A: Po ti asnjëherë nuk më le mua të ushtrohem.
B: Nuk kemi nevojë për ty në skuadrën tonë.




Komunikimi Pozitiv:



- A: Unë u nevríkosa kur ti nuk ma pasove topin, sepse unë kam nevojë të ushtrohem.
B: Edhe unë u nevríkosa kur ti u bashkove me skuadrën tonë, sepse ne jemi gjithë ato veta.
A: Po unë gjithmonë ngelem jashtë loje.
B: Mirë, të siguroj që do të luash herës tjetër.
A: Faleminderit.

Kur ne përpiqemi të shpjegojmë se si ndjehemi, na ndihmon të kuptojmë më mirë njëri-tjetrin. Kjo është një gjë mjaft e rëndësishme kur duam të zgjidhim problemet midis nesh.




AFTËSITË QË DUHET TË KETË NJË NDËRMJETËS

-  1. Të jetë i aftë të dëgjojë me shumë kujdes argumentet e të dy palëve.
-  2. Të qëndrojë i paanshëm, gjë që do të thotë të mos mbajë anën (hatrin) e ndonjërit.
-  3. Të ndihmojë që personat të zgjidhin vetë problemin e tyre, e jo ta zgjidhë ai/ajo për ta.



USHTRIM:



A mund të ndryshoni shembullin e komunikimit negativ në një shembull komunikimi pozitiv?

A: Ta marrë dreqi!
Ti nuk ke për të ma pasuar topin gjatë orës së lojës.

A. Po ti asnjëherë nuk më le mua të praktikohem.

B. Pse të duket e mirë vetja me top ty?

B. Nuk kemi nevojë për ty në skuadrën tonë.

Plotësoni fjalët që mungojnë duke krijuar modelin tuaj të komunikimit pozitiv për të njëjtën situatë.

Unë u ndjeva _____

Kur ti _____

Sepse _____

Kapitulli



Muri i mundësive
dhe Lule mos më prek



Çfarë mund dhe nuk mund
të bëjë Qeveria e Nxënësve?!

MURI I MUNDËSIVE



Qeveria e Nxënësve mund
të organizojë aktivitete
të llojeve të ndryshme.

Qeveria e Nxënësve
mund të hedhë ide
të ndryshme për
aktivitete, konkurse etj.

Qeveria e Nxënësve
mund të merret me
mjediset e shkollës.

Qeveria e Nxënësve
mund të këshillojë.



Qeveria e Nxënësve
mund të eliminojë
problemet.



Qeveria e Nxënësve
mund të këshillojë
nxënësit e shkollës për
mbajtjen e rregullit,
pastërtisë, disiplinës, etj.

Qeveria e Nxënësve mund
të rregullojë
një xham të thyer.

Qeveria e Nxënësve
mund të marrë nisma për
të ndihmuar nxënësit në
lëndë të ndryshme.

Qeveria e Nxënësve mund
të ndihmojë nxënësit
që kanë nevojë.



Qeveria e Nxënësve mund
të organizojë seminare për
zgjerim njohurish.

LULE

Qeveria e Nxënësve
nuk mund të përjashtojë
nxënës nga shkolla.

Qeveria e Nxënësve
nuk mund të blejë pajisje
për laboratorë.

Qeveria e Nxënësve
nuk mund të paguajë
energjinë elektrike.

Qeveria e Nxënësve
nuk mund të urdhërojë,
por këshillojë.

Qeveria e Nxënësve
nuk mund të organizojë
mbërmbje me ushqim.

Qeveria e Nxënësve
nuk mund të organizojë
ekskursione jashtë
qytetit.

Qeveria e
Nxënësve
nuk
mund të thyejë
rregulloren
e shkollës.

Qeveria e
Nxënësve
nuk mund
të pushojë
mësuesit nga
puna, por mund
të propozojë
ndryshime.

MOS MË PREK

Qeveria e Nxënësve nuk mund t'i realizojë të gjitha idetë sepse nuk i ka paratë.

e nevojshme për realizimin e këtyre ideve, qofshin të mira ose të këqija.

Qeveria e Nxënësve nuk mund të riparojë bangot e verme.

Nuk mund të zgjidhë të gjitha problemet e shkollës.

Nuk mund të bëjë një palestër për zhvillimin e lëndës së fiskulturës ose për argëtimin e nxënësve në kohën e lirë.

Nuk mund të plotësojë çdo kërkesë për shkak të fondeve.

Nuk mund të bëjë shumë aktivitete për arsye financiare.

Qeveria e Nxënësve nuk mund të blejë uniformat.

Qeveria e Nxënësve nuk mund të riparojë kanalet e ujërave të zeza.

Nuk mund të bëhet asnjë aktivitet e presidentit.



Kapitululli



TË PËRFSHIJMË TË TJERËT

Anëtarët e Qeverisë së Nxënësve duhet të përfaqësojnë jo vetëm mendimet e tyre, por edhe të nxënësve të tjerë. Është shumë e rëndësishme që të gjithëve t'u jepet mundësia të shprehin mendimet e tyre, edhe pse nuk janë anëtarë të Qeverisë së Nxënësve.



Pse është e rëndësishme të përfshijmë të tjerët?

Të gjithë duhet të marrim pjesë, pasi ata na kanë zgjedhur. Pa nxënësit e tjerë ne do të ishim si peshku pa ujë. Ata janë arsyeja që ne punojmë.



SI TË PËRFSHIJMË TË TJERËT?

Kërkoni që nxënësit t'i japin senatorit,
me shkrim ose me gojë,
mendimet e tyre.



Organizoni takime me klasën
për të mbledhur idetë e tyre.



Organizoni pyetësorë të ndryshëm për
mbledhjen e sugjerimeve të të tjerëve.



Bashkëpunoni me mësuesit në rast
se e shikoni të nevojshme.
Mund të krijoni kutinë e mendimeve.



Organizoni aktivitete të hapura për të gjithë,
si psh aktivitete sportive-kulturore.



ANKETA

1. A të pëlqenë të marrësh pjesë në konkursin e pikturës?

a. Po b. Jo

2. Çfarë do të doje të organizoje?

a. Ekspozitë b. Konkurs

3. Si doni të vizatoni?

a. Vaj b. Laps c. Akuarel

4. Çfarë doni të pikturoni?

a. Natyrë e qetë

b. Karikaturë

c. Abstraksion



Anketa



1. Si ndiheni në shkollë?
a. mirë b. keq c. i fyer



2. Çfarë lloj aktivitetejsh ju pëlqen të organizoni?
a. sportive b. kulturore c. Sociale



3. A ju ka ndihmuar ndonjë herë Qeveria e Nxënësve?
a. po b. jo c. Pak



4. Çfarë mendoni për Qeverinë e Nxënësve?
a. e keqe b. e mirë c. E shkëlqyer



5. A keni qenë i ftuar në aktivitetejsh të tyre?
a. po b. Jo



6. A informoheni nga Qeveria e Nxënësve?
a. po b. jo c. jo aq sa duhet



7. Ç'marrëdhënie keni me senatorin?
a. të mirë b. të keqe c. të shkëlqyera



Mendime mbi Qeverinë e Nxënësve

E përgjithshme



1. Ç'efekt ka mbi ju Qeveria e Nxënësve?



2. A keni dëshirë të përfshiheni në Qeverinë e Nxënësve dhe pse?



3. Ç'komunikim keni me senatorët, si tregohen ata ndaj jush?



4. A merrni pjesë në aktivitetet që organizon Qeveria e Nxënësve?



5. A e njihni Qeverinë e Nxënësve dhe çfarë mendoni për të?



6. A keni kërkuar ndihmë tek Qeveria e Nxënësve dhe si kanë reaguar?



7. A ju kanë caktuar ndonjë detyrë ndonëse nuk përfshiheni?





Mendime mbi Qeverinë e Nxënësve

Specifike

1. Cili sport të pëlqen më shumë?

- a. futboll
- b. volejball
- c. basketboll

2. A jeni i interesuar të merrni pjesë në këtë spartakiadë?

- a. po
- b. jo
- c. indiferent

2. A ju intereson ky aktivitet?

- a. pak
- b. shumë
- c. fare

4. A do të jeni i gatshëm të kontribuoni për këtë aktivitet?

- a. financiarisht
- b. fizikisht
- c. moralisht
- d. vullnetarisht





1. Letër një nxënësi që është problem.

*I dashur shoku ynë Valdrin,
Ajo që na shtyu të të shkruajmë është sjellja jote e keqe. Ti ke qenë një nxënës i mirë dhe shumë i dashur me shokët e tu. Kemi biseduar edhe me drejtorin që ty të të ndihmojë duke mos e marrë vendimin për përjashtim. Ne mund të të ndihmojmë duke biseduar edhe me mësueset që ti ke probleme dhe gjithashtu për ndonjë gjë që të nevojitet.*

Të lutemi, të premtën pasdite, të vish të na takosh në mbledhjen që organixon Deveria e Nxënësve dhe ne mund të të ndihmojmë fare mirë.

Me respekt

Deveria e Nxënësve "Demir Gashi"



2. Letër një biznesmeni



Ënderuar zotëri,

Me anën e kësaj letre duam t'ju falenderojmë për kontributin që keni dhënë në shkollën tonë për realizimin e aktivitetit "Më i miri". Megjithatë ne si Deveria e Nxënësve të shkollës "Selim Alliu" ju ftojmë të merrni pjesë në aktivitetin e organizuar për 8 Marsin si një ndër biznesmenët më të mirë që keni dhënë një kontribut të çmueshëm për shkollën. Ju lutemi të kontribuoni edhe ju për këtë aktivitet; të tjerat ne si Deveri Nxënësish i përgatisim vetë. Do të donim që përpara këtij aktiviteti të linim një takim.

Me nderime

*Deveria e Nxënësve
"Selim Alliu"*





LETËR KRYETARIT TË BASHKISË

*I nderuar zoti Kryetar i Bashkisë,
Ne Deveria e Nxënësrve të shkollës "Demir Gashi",
ju falenderojmë ju dhe stafin tuaj për investimet e bëra
në qytetin tonë si: rregullimin e lulishteve, pastrimin e
qytetit, ndriçimin, asfaltimin, gjelbërimin etj. Ne
Deveria e Nxënësrve, krahas këtyre investimeve duam
të kontribuojmë sado pak në gjelbërimin e qytetit tonë
dhe kërkojmë nga ana juaj të na ndihmoni me 200
(dyqind) fidanë, pemë dekorative, dhe për këtë ju
sigurojmë që nga ana jonë do të bëhen këto punime:
hapje gropash, mbjellje dhe rrethim i tyre, gjithashtu do
të mirëmbajmë ato. Ju mirëpresim në një takim kur
ju ta shihni të arsyeshme.*

*Me respekt Deveria e Nxënësrve,
"Demir Gashi"*


4. LETËR NJË DREJTORI


*Peshkopi më 26/04/2003
I nderuar Loti Drejtor,
Ne Deveria e Nxënësve ju falenderojmë për
gadishmërinë që treguat me rastin e festave të 7-8
Marsit. Me rastin e festës së 1 Majit ne kemi
menduar të organizojmë një aktivitet për të gjithë
mësuesit e punëtorët e tjerë të shkollës. Ne kërkojmë
nga ju që të na jepni sallonin e shkollës ditën e enjte,
më datë 1 Maj. Shpresojmë në ndihmën tuaj.
Ne gjithashtu do të bashkëpunojmë në mirëmbajtjen
dhe në blerjen e gjërave.*

Me respekt

Deveria e Nxënësve, "Selim Alliu"

P.s. Ne do të vimë vetë
t'ju takojmë për t'u
marrë vesh.





Kush duhet të dëgjojë dhe kë duhet të dëgjojmë?
 Të krijosh një shkollë një atmosferë ku dëgjohet mendimi
 i të gjithëve! Shikoni diagramën. Shigjetat tregojnë se kujt
 i kërkohet mendimi dhe se kë dëgjon secili grup.



TË DËGJOSH NXËNËSIT E TJERË!

Diskutoni me shokët tuaj se për çfarë gjërash të jetës në shkollë do të donit ju që të rriturit t'ju merrnin mendim?

(PSh. Si mendoni për fushën e sportit, për banjat, apo për ndonjë problem tjetër në shkollë?)

Pse nuk bëni një lojë të tillë me gjithë klasën. Individualisht, secili plotëson fjalinë e mëposhtme:
Do të doja të diskutoja mbi.....

Çdonjëri lexon fjalinë e plotësuar përpara klasës.

A duan nxënësit e klasës tuaj të diskutojnë mbi problemet e shkollës?

A duan nxënësit e klasës tuaj t'u dëgjohet mendimi?

A duan nxënësit e klasës tuaj të dinë se çfarë mendojnë nxënësit e klasave të tjera?



Ka dhe një lojë tjetër argëtuese.

Ju i jepni diagramën nxënësve të klasës, por pa i vendosur shigjetat. Kërkojini atyre t'i vizatojnë shigjetat, duke patur parasysh se kahu i shigjetës tregon se kujt i marrim mendim, dhe kahu tjetër, atë që na merr mendimin.

Mësuesit
e tjerë.

Prindërit

Mësuesi
kujdestar



Nxënësi

Qeveria
qëndrore

Drejtori

Inspektori

Edhe një lojë të fundit.

Kërkojini nxënësve të klasës të tregojnë çështje që duan të diskutojnë përmes Qeverisë së Nxënësve.

Kjo mund të shprehet në mënyra të ndryshme.

Disa e prezantojnë me vizatime, disa me maska, disa me gjëgjëza dhe disa me këngë. Ju këto çështje pastaj i diskutoni në Qeverinë e Nxënësve.

Do të ishte gallatë, po që se dhe ju do t'i prezantonit me këto llojë mënyrash çështjet për diskutim në Qeverinë tuaj të Nxënësve. Pasi gjërat të diskutohen dhe të marrin një zgjidhje, atëherë po me këto llojë prezantimesh e tregoni zgjidhjen në klasë.

Kujtesë: Problemin dhe zgjidhjen mund ta prezantoni me gallata. Po ama zgjidhjen duhet ta bëni seriozisht!



Kapitulli



Konventa për të Drejtat
e Fëmijës

Konventa për të Drejtat
e Fëmijës është për të
gjithë ata që janë nën
moshën 18-vjeç.

Neni 1

Të gjithë fëmijët
pa dallim kanë këto
të drejta.

Neni 2

Çdo gjë duhet të jetë
në interesin më
të mirë të fëmijës.

Neni 3

Qeveria duhet të
mbështesë të drejtat
e fëmijëve.

Neni 4

Shteti duhet të respektojë
të drejtat dhe detyrat
që kanë prindërit ndaj
fëmijës.

Neni 5

E drejta për
të jetuar.

Neni 6

E drejta për të patur
emër dhe kombësi.

Neni 7

E drejta për të
ruajtur identitetin.

Neni 8

E drejta për t'u larguar nga vendi e për të jetuar me prindërit atje ku ata ndodhen.

Neni 10

E drejta për të jetuar me prindërit nëse kjo është më e mira.

Neni 9

E drejta për t'u mbrojtur nga rrëmbimi.

Neni 11

E drejta për të shprehur mendimin në çështjet që lidhen me fëmijët.

Neni 12

E drejta për të patur informacion.

Neni 13

E drejta për të zgjedhur besimin fetar.

Neni 14

E drejta për të zgjedhur shokët tuaj dhe për t'u grumbulluar në grupe e shoqata.

Neni 15

E drejta për të pasur jetë private, si p.sh. të hapësh letrat personale.

Neni 16

E drejta për të pasur informacionin e nevojshëm nëpërmjet gazetave, tv, etj.

Neni 17

Të dy prindërit kanë një lloj përgjegjësie për rritjen dhe edukimin e fëmijëve.

Neni 18

E drejta për t'u mbrojtur nga keqtrajtimi dhe mospërfillja.

Neni 19

E drejta për t'u mbrojtur dhe përkujdesur në rast se familja nuk e bën këtë.

Neni 20

E drejta e birësimit nëse kjo është në interesin më të mirë të fëmijës.

Çdo fëmijë që largohet nga vendi i tij sepse i rrezikohet jeta, ka të drejtë të jetojë në një vend të sigurt.

Neni 21


Neni 22

Fëmijët me paaftësi kanë të drejta si të gjithë fëmijët e tjerë.

E drejta për kujdes dhe shërbim shëndetësor edhe kur je i sëmurë apo i varfër.

Neni 23

Neni 24



E drejta për kujdes të rregullt dhe kontroll të vazhdueshëm mjekësor për fëmijët që janë nën kujdesin e shtetit.

Neni 25



E drejta për përkrahje shoqërore.

Neni 26




E drejta për një nivel jetese të përshtatshëm.

Neni 27




E drejta për arsim.

Neni 28



Arsimi që merrni duhet t'ju ndihmojë për t'u zhvilluar e për t'u rritur.

Neni 29



Çdo fëmijë ka të drejtë të ndjekë besimin fetar, gjuhën dhe kulturën e tij.

Neni 30



E drejta për kohë të lirë,
argëtim dhe pjesëmarrje.


Neni 31

E drejta për të mos
punuar deri sa të arrihet
mosha e lejueshme.

Neni 32

E drejta për të mos
përdorur dhe prodhuar
drogë.

Neni 33





E drejta për t'u mbrojtur nga abuzimi seksual, trafikimi, tortura dhe nga çdo formë tjetër shfrytëzimi.

Neni 34, 35, 36, 37



E drejta për t'u mbrojtur në kohë luftrash dhe e përkujdesjes në raste lëndimesh.

Neni 38, 39



E drejta e pafajësisë deri sa të provohet faji. E drejta për të mbrojtur veten dhe kërkuar ndihmë nëse nevojitet.

Neni 40



E drejta për respektimin e të gjitha të drejtave dhe ligjeve që kanë të bëjnë me fëmijët.

Neni 41

Nëse ju kujtohet në faqet e para të këtij libri janë shkruar disa pyetje që shpesh bëhen nga fëmijët. Përgjigjen e tyre ju ndoshta tashmë e keni marrë, por për të patur më shumë informacion unë do t'ju pajis me disa të dhëna të tjera. Lexoni këtu poshtë:



Sa Qeveri Nxënësish ka gjithsej në Shqipëri.

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ka nxjerrë një rregullore për të gjitha shkollat në të cilën thuhet që në çdo shkollë shtetërore duhet të ketë Qeveri Nxënësish. Numri i përgjithshëm i shkollave 8-vjeçare në të gjithë Shqipërinë është 1744.

Kështu pra duhet të merrni me mend që secila nga këto shkolla duhet të krijojë Qeverinë e vet të Nxënësve, por kjo jo gjithmonë funksionon.

Aktualisht, si rezultat i një projekti të organizatës Save the Children (Shpëtoni Fëmijët) i cili zbatohet në Dibër dhe Korçë funksionojnë rreth 30 Qeveri Nxënësish të cilat përpiqen të realizojnë aktivitetet e tyre.



A kanë lidhje me Qeverinë e vërtetë dhe a ndihmohet prej saj?

Mundësinë për ekzistencën e Qeverisë së Nxënësve e ka dhënë Ministria e Arsimit, e cila është pjesë e Qeverisë së vërtetë. Brenda shkollës Qeveria e Nxënësve është e lirë të zhvillojë aktivitete për çështje që kanë lidhje me fëmijët dhe qëndrimin e tyre në shkollë.



A ka ndarje partiake në Qeverinë e Nxënësve?

Ndarje partiake nuk ka dhe nuk ka kuptim të ketë, pasi Qeveria e Nxënësve krijohet nga vetë nxënësit me pjesmarrjen e tyre të lirë. Nxënësit që bëjnë pjesë në këtë qeveri janë të barabartë dhe punojnë së bashku për më të mirën e gjithë nxënësve të tjerë.



Çfarë aktivitete zhvillon Qeveria e Nxënësve?

Ato që mund të bëjë Qeveria e Nxënësve janë shumë, por le të japim disa ide. Me siguri ju do t'i shtoni shumë aktivitete të tjera kësaj liste:

- Kujdeset që shkolla të jetë më e mirë.
- Ndhmon nxënësit në nevojë.
- Organizon aktivitete masive kulturore, artistike, sportive, konkurruese, etj.
- Organizon debate për liritë dhe të drejtat e fëmijëve.
- Jep mesazhe për paqen, si ta duam njëri-tjetrin.
- Shkruan libra si ky që ju keni në dorë.

FJALOR



A

Aftësi. Të qenit i aftë, prirja për të kryer diçka, persona që shquhen në një drejtim të caktuar.

Aktivitete. Veprimtari të programuara të një grupi nxënësish që zhvillohen në mënyrë aktive.

Autoritet. Vlera me aftësi të dikujt të fituara me punë që ngjallin bindje dhe besim tek të gjithë.

B

Bashkëpunoj. Punoj bashkë me një tjetër ose një grup personash për të kryer një aktivitet.

Buxhet. Të ardhurat financiare që shpenzohen për aktivitete të ndryshme të Qeverisë së Nxënësve.

D

Diagramë. Vizatim, skicë që tregon mënyrën e funksionimit dhe lidhjen midis gjërave.



FJALOR

D

Drejtë(i,e). Tërësia e normave që rregullojnë marrëdhëniet shoqërore nëpërmjet njerëzve; mundësi që sigurohen me vendime për të gëzuar, për të kërkuar a përdorur diçka, për të vepruar në një mënyrë të caktuar. Në rastin konkret, e drejta për t'u arsimuar, për të shprehur mendimet lirisht etj.

Dh

Dhunë. Person fizik apo psikik ndaj dikujt për ta detyruar të bëjë diçka jashtë dëshirës së tij.

E

Edukim. Proçes nëpërmjet të cilit shoqëria transmeton vlerat e saj, besimet njohuritë tek anëtarët e saj të rinj.

G

Grup. Një numër i caktuar nxënësish që kanë ide dhe qëllime të njëjta, që janë të organizuar dhe kryejnë aktivitete të përbashkëta.

H

Hierarki. Rendi i titujve, i gradave ose i përgjegjësive nga më të ultat deri te më të lartat.

I

Indiferent. Që rri mënjanë, nuk i bën përshtypje asgjë, nuk përfshihet aktivisht në zgjidhjen e problemeve.

L E G H

FJALOR



I

Inteligjent. Person me aftësi mendore për të arsyetuar apo gjykuar për një problem, nxënës i zgjuar dhe i shkathët.



K


Komunikim. Proçes i dhënies, shkëmbimit të informacionit nëpërmjet një individi apo grupi njerëzish në mënyrë të vullnetshme.

Këmbëngulës. Që ngul këmbë për diçka, që përpiqet me të gjitha forcat për realizimin e një detyre.


Koordinoj. Që përshtat idetë, mendimet dhe aktivitetet e grupeve të ndryshme të nxënësve; që programon aktivitete gjithëpërfshirëse të nxënësve.

Kutia e mendimeve. Është një kuti që vendoset në një vend të caktuar të shkollës ku nxënësit vullnetarisht shprehin mendimet dhe sugjerimet e tyre me shkrim për çështje të ndryshme të shkollës.

FJALOR



Miqësor. Sjellje dhe veprime që kryen në të mirë të njëri-tjetrit, që kryen me dashamirësi.



Përgjegjësi. Detyrim që ka dikush për t'u përgjigjur për veprimet e tij, ndjenjë e lartë që ka dikush për të kryer sa më mirë një punë.

Përfaqësoj. Veproj i ngarkuar nga një grup nxënësish për të mbrojtur të drejtat e tyre; shpreh dëshirat, vullnetin e grupit; jam zëdhënës i tyre

Përvojë. Tërësia e njohurive, shprehive që fitohen nëpërmjet aktiviteteve të nxënësve; diçka që e kemi provuar më parë, e kemi jetuar dhe prej së cilës kemi nxjerrë mësim.

Preferencë. Përdoret për diçka që pëlqehet më shumë se diçka tjetër.

Problem. Çështje që shtrohet për t'u zgjidhur.

Pyetësor. Një tërësi pyetjesh që bëhen për të mbledhur të dhëna për diçka që na intereson.



M

P

F5ALOR



Qeveria e Nxënësve. Një grup nxënësish që përfaqësojnë mendimin e të gjithë nxënësve për çështje të shkollës që kanë lidhje me ta.



Raportim. Jap sqarime të hollësishme për një problem me shkrim ose me gojë.




Senator. Person i zgjedhur që përfaqëson klasën në Qeverinë e Nxënësve dhe përpiqet për zgjidhjen e problemeve të saj.

Sugjerim. Këshill, mendim, opinion, propozim për diçka.



Trainim. Aktivitet në grup që ka për qëllim plotësimin e njohurive të pjesmarrësve në një çështje të caktuar.





U

Udhërrëfytes. Përdoret për individët që u tregojnë të tjerëve rrugët apo drejtimet që duhet të ndiqen për të zgjidhur një problem.



Vendim. Qëndrim përfundimtar për një çështje që është vendosur të kryet, detyra që përcaktohen në një mbledhje dhe që duhet të bëhen.

Vlerësim. Jap mendimin për dikë apo diçka; përcaktoj rëndësinë e diçkaje.

Votë. E drejta e secilit për të shfaqur mendimin dhe vullnetin e tij në momente zgjedhjeje në organet shkollore.

Vullnetar. Grupe apo individë që kryejnë aktivitete apo detyra me dëshirë dhe pa shpërblim.




Zgjedhje. Përdoret për procesin e votimit për të zgjedhur përfaqësuesit në Qeverinë e Nxënësve.

U V Z


Foto të marra gjatë procesit të shkrimit të këtij libri.



Ë gjetëm zgjidhjen...



... është Qeveria e Nxënësve!



SAVE THE CHILDREN
Rr. "Komuna e Parisit"
Vila Lami, Nr. 1
Tiranë, Shqipëri
Tel:04226840/04226929